



01 Nr. 470/24 Dt. 02.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e ndryshimeve në projekt, punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, konform rekomandimit të Organit Mbikëqyrës, për lejimin e ndryshimeve në projekt (kolaudim të sasive), lejimin e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: “Ndërtimi i kullës së Remzi Ademaj” në fshatin Romajë”, kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti lejohen ndryshimet në projekt, punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 17.442,50 € (shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e katërdhjetë e dy euro e pesëdhjetë cent).
2. Pagesa e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t’i bëhet përfituesit të kontratës së punës, nr. prok. 622-23-2457-5-2-1.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nr. 53622.
4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

